




RAPORTI I DHJETË NGA MONITORIMI I CILËSISË SË DEBATIT NË KUVENDIN



KUVENDI NËN THJERRËZ

**Përforcimi i debatit politik
dhe diskursit deliberativ**

MAJ 2015



RAPORTI I DHJETË NGA MONITORIMI I CILËSISË SË DEBATIT NË KUVENDIN (MAJ 2015)

Instituti për demokraci "Societas Civilis" – Shkup (IDSCS) dhe Instituti për Evropën Lindore dhe Qendrore dhe Ballkanin (IELQB), duke filluar nga qershori i vitit 2014 deri në mars të vitit 2015 e përcjellin nivelin e cilësisë së debatit në Kuvendin dhe raportimin e medieve nga puna e deputetëve. Monitorimi zhvillohet në kuadër të projektit "Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ" financiarisht i përkrahur nga Unioni Evropian. Gjatë periudhës së monitorimit do të përgatiten dhjetë raporte mujore për cilësinë e debatit në Kuvendin. Para jush është raporti i fundit, i dhjetë i cili ka të bëjë me debatin kuvendor në muajin maj të vitit 2015.

Me aplikimin e "Indeksit për cilësi të debatit"¹ sipas disa parametrave vlerësohet çdo fjalim i veçantë i pjesëmarrësve në seancat plenare dhe seancat e tetë komisioneve kuvendore të përzgjedhura sipas rëndësisë së tyre për debatin politik dhe kulturën politike në shtetin.

Qëllimi i monitorimit është që në mënyrë empirike, të fitohen njohuri se sa janë të argumentuara diskutimet në shtëpinë ligjvënëse dhe se sa qëndrimet e ndryshme merren parasysht dhe kontribuojnë në krijimin e ligjeve.

Në të njëjtën kohë, në kuadër të projektit realizohet edhe monitorimi i disa medimeve kombëtare² për tu parë se në çfarë mase opinioni është i njoftuar me esencën e debateve kuvendore dhe me përmbajtjen e argumenteve të shfaqura në seancat nga ana e deputetëve.

Pas çdo muaji të monitoruar opinioni do të informohet përmes raporteve për gjetjet kyçe nga monitorimi i debatit në Kuvendin dhe të informimit media

A. REZYME

Deputetët në maj e rritën interaksionin e ndërsjellë nëse merret parasysht se, krahasuar me muajin paraprak, u zvogëluar përqindja e fjalimeve individuale, ndërsa u rritën replikat dhe kundër-replikat. Kjo është indikator se deputetët në këtë periudhë më shpesh kanë hyrë në diskutime rreth pikave të rendit të ditës të Kuvendit krahasuar me muajin prill. Prapëseprapë edhe në muajin maj sipas llojit të fjalimeve pjesa më e madhe shkon në fjalimet individuale - 70%.

¹ Indeksi për cilësi të debatit (Discourse Quality Index) është i krijuar nga një grup i teoricienëve prijës botëror demokracisë deliberative (debatuese). Indeksi paraqet metodologji e cila mundëson hulumtim empirik të cilësisë së debateve, forma dhe përmbajtja e të cilave, sipas teoricienëve, janë jashtëzakonisht të rëndësishme për demokracinë në një shoqëri. Indeksi gjatë viteve të fundit është përdorur për hulumtim të debatit në Parlamentin Evropian edhe në parlamentet e Gjermanisë, Zvicrës dhe në Kongresin amerikan.

² Monitorimi i medieve i përfshin televizionet kombëtare Sitel, Tellma, Alsat-M dhe RTM2 në gjuhën shqipe dhe gazetat Dnevnik, Silloboden pečat, Utrinski vesnik, Večer, Koha dhe Lajm.



Është rritur numri i diskutimeve në të cilat deputetët i ndërlihdin pozitat dhe argumentet e veta me të mirën e përgjithshme të të gjithë qytetarëve. Për llogari të kësaj, është zvogëluar përqindja e diskutimeve në të cilat deputetët kanë qenë neutral, përkatësisht nuk i ndërlihdin argumentet e veta me përfitimet ose pasojat e mundshme për asnjë grup në shoqërinë.

Në maj, deputetët pak më rrallë i mbështesin qënderimet e veta me nga dy dhe më tepër argumente krahasuar me prillin. Përqindja e diskutimeve të këtilla në maj arriti 47% (në prill – 51%).

Deputetët në seancat e monitoruara në prill më shpesh i arsyetuan pozicionet e veta me nga dy e më tepër argumente, ndërsa është zvogëluar përqindja e arsytimit me nga një argument. Diskutimet të cilat janë vlerësuar si “të dobëta” që do të thotë arsyetim pa argumente të plota është vërejtur në 12% nga diskutimet e tërësishme.

Njëloj si gjatë vazhdës së tërë monitorimit, deputetët edhe në maj sërish nuk patën sukses të binden në drejtësinë e argumenteve të veta dhe çdokush mbeti në “istikamin” e vet. Sërish nuk është vërejtur rast që deputeti ta ndryshojë pozicionin e vet për shkak të argumenteve më cilësore të shfaqura në debatin. Prapëseprapë, janë vërejtur vetëm dy raste kur deputetët e ndryshuan pozicionin, por pa arsyetim për të cilat shkaqe e kanë bërë atë.

Opozita e përfaqësuar nga 11 deputetë në prill kishte pjesëmarrje në diskutimet prej 20% gjë e cila është rritje krahasuar me prillin. Kjo rritje në masë të caktuar ka të bëjë edhe me atë që opozita është e përfaqësuar me një deputet më tepër për dallim nga muajt paraprak kur opozita ishte e përfaqësuar prej 10 deputetë.

Interesim më të madh për diskutim te deputetët në maj shkaktoi seanca e kushtuar pyetjeve të deputetëve drejtuar qeverisë, propozimi për zgjedhje të anëtarëve të Qeverisë³, propozim ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për mbrojtje të konsumatorëve dhe raporti vjetor i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë. Një pjesë e pikave të tjera të rendit të ditës kaluan me diskutim të pakët dhe të njëanshëm ose pa kurrfarë diskutimi.

Me tërë këtë, qëndron konkluzioni se opinioni sërish mbeti më i varfër për debat cilësor për një pjesë të zgjidhjeve ligjore. Është lëshuar mundësia që përmes diskutimit të testohet vlefshmëria dhe qëndrueshmëria e argumenteve të prezantuara si dhe mundësia që ato të kontestohen ose plotësohen, gjë e cila do të kishte kontribuar për miratimin e ligjeve më të mira në favor të të mirës së përgjithshme dhe të interesit publik.

³ Në seancën për zgjedhje të anëtarëve të ri të Qeverisë, deputetët diskutuan për propozimin për ministra të ri për punë të brendshme dhe për transport dhe lidhje pasi që ministrat paraprak Gordana Jankullovska dhe Mile Janakievski dhanë dorëheqje në funksionet e tyre. Në vendin e tyre Kuvendi e pranoi propozimin e Qeverisë dhe i zgjodhi Mitko Çavkov për ministër të punëve të brendshme dhe Vllado Misajlovski për ministër të transportit dhe lidhjeve.



B. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

“Indeksi i cilësisë së debatit” mundëson që çdo debat i veçantë i shfaqur në seancat të kodifikohe sipas disa karakteristikave kryesore:

- shkalla e argumentimit të fjalimit⁴;
- shkalla e respektit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumenteve të tyre;
- çiltërsia për pranim të argumenteve të huaja dhe ndryshim të qëndrimeve të veta nën fuqinë e argumenteve të prezantuara në debatin;
- nëse deputetët arsyetojnë se në emër të kujt dhe interesat e kujt i prezantojnë qëndrimet e veta;
- nëse deputetët mund pa pengesa të shfaqin qëndrimet e veta dhe
- në çfarë mase është i pranishëm fjalori i pahijshëm.

Me monitorimin janë përfshirë debatet në trupat vijuese punuese në Kuvend:

- Seanca plenare;
- Komisioni për çështje kushtetuese;
- Komisioni për financa dhe buxhet;
- Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive;
- Komisioni për zgjedhje dhe emërime;
- Komisioni për vetëqeverisje lokale;
- Komisioni për çështje evropiane;
- Komisioni anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit;
- Komisioni ligjvënës juridik.

V. KONTEKSTI POLITIK

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Deputetët zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave proporcionale zgjedhore për mandat për katër vjet. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill të vitit 2014, parti Organizata e brendshme maqedonase revolucionare – Parti demokratike për unitet kombëtar maqedonas (OBMR-PDUK ose maqedonisht VMRO-DPMNE) fitoi 61 deputet, ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin ata e themeluan qeverinë, Bashkimi demokratik për integrim (BDI ose DUI), fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë të Opsionit qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (NDP). Deputeti i cili mandatin e

⁴Nën shkallë të argumentimit merren parasysh numri i argumenteve me të cilat deputeti në fjalimin e tij i arsyeton pozicionet e veta duke mos hyrë me këtë rast në vërtetësinë ose vlefshmërinë e argumenteve. Me këtë rast nuk merren parasysh argumentet të cilat në mënyrë të qartë dhe pa dyshim janë nga tema e debatit.



morri nga RDK edhe përkundër vendimit të partisë që ta bojkotojë Kuvendin ju bashkëngjijt grupit të deputetëve të BDI-së. Me atë tani grupi parlamentar i BDI-së numëron 20 deputetë.

Nga fillimi i monitorimit deri në botimin e raportit të parë, deputetët nga koalicioni më i madh opozitar të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM ose SDSM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotojnë punën e Kuvendit.⁵ Në muajin shkurt në Kuvendin si opozitë vepronin dhjetë deputetë, shtatë nga Partia demokratike shqiptare (PDSH) dhe tre nga koalicioni opozitar i LSDM të cilët vendosën ti pranojnë mandatet. Shumica në Kuvendin në nëntor e filluan procedurën për marrje të mandateve të 31 deputeti opozitar të cilët e bojkotojnë parlamentin. Procedura deri në publikimin e këtij raporti ende nuk ka përfunduar. Kah fundi i janarit, Zoran Zaev, lideri i opozitës të udhëhequr nga LSDM në pres-konferenca filloi ti shpalojë ashtuquajturat “bomba”, përkatësisht, siç deklarojnë, audio incizimet për funksionarë të lartë shtetëror. Më 30 mars përfaqësues të dy partive më të mëdha VMRO-DPMNE dhe LSDM u takuan në Bruksel në negociatë për zgjidhjen e krizës politike me ndërmjetësim të tre deputetëve⁶ nga Parlamenti Evropian. Liderët e dy partive i përsëritën negociatat edhe më 15 prill mirëpo, njëllor si herën e parë takimet nuk sollën zgjidhje e as lëvizje përpara në gjendjen politike. Në maj u mbajtën dy takime të liderëve të katër partive më të mëdha politike në Maqedoni. Qëllimi i takimeve të liderëve ishte gjetja e e zgjidhjes për krizën politike, mirëpo edhe këto takime nuk arritën të sjellin zgjidhje për gjendjen aktuale politike.

Më tetë maj partia Përtërirja demokratike për Maqedoninë (PDM ose Demokratska obnova ya Makedonija – DOM) e cila ka një deputet në Kuvendin (Liljana Popovska) vendosi ta braktis koalicionin qeverisës. Sipas partisë me këtë hap ata do të kontribuojnë ndaj lehtësimit të gjendjes së tensionuar të skenës politike. Me këtë ndryshim shumica qeverisëse për momentin numëron 81 deputet, ndërsa opozita 11 deputetë.


G. GJETJE NGA MONITORIMI

Ky raport e përfshin debatin në Kuvend në periudhën nga 1 deri më 31 maj të vitit 2015. Janë analizuar gjithsej 150 fjalime të pjesëmarrësve të debateve në gjithsej 8 seanca nga të cilat 6 janë plenare dhe 2 janë seanca të trupave punuese. Nga seancat e trupave punuese, janë përcjellë nga një seancë e Komisionit për financim dhe buxhet dhe Komisionit për çështje evropiane.

Nga numri i tërësishëm i fjalimeve të monitoruara, 103 janë të deputetëve në Kuvendin, ndërsa 47 të pjesëmarrësve të jashtëm si ministra, përfaqësues të ministrive, institucione të tjera shtetërore dhe publike. Ky raport ka të bëjë vetëm me fjalimet e deputetëve.


⁵ Deputetët opozitare Roza Topuzovska Karevska nga Partia Liberale demokratike, Sollza Gërçeva dhe Lubica Buralieva nga LSDM vendosën ti pranojnë mandatet e deputetit të fituara në zgjedhje edhe përkundër vendimit të koalicionit opozitar për bojkot të punës së Kuvendit.

⁶ Në bisedimet në Bruksel midis përfaqësuesve të VMRO-DPMNE-së në pushtet dhe të LSDM-së opozitare ndërmjetësuan deputetët nga Parlamenti Evropian Ivo Vajgëll, Riçard Hovit dhe Eduard Kukan.




Në raport me karakteristikat demografike të deputetëve që kanë folur, sipas:


- Seksit: 47% janë burra, ndërsa 53% janë gra.
- Përkatësisë etnike: 91% janë Maqedonas etnik, 7% Shqiptarë etnik, 2% janë të tjerë.
- Arsimit, 69% janë me arsim të lartë, 23% magjistra 7% doktorë të shkencave, ndërsa 1% janë me arsimim të mesëm.
- Në maj në seancat e monitoruara më aktiv ishin deputetët nga njësia e parë zgjedhore, ndërsa më pak diskutime kishin deputetët nga njësia e gjashtë zgjedhore.




Në maj deputetët opozitar e rritën pjesëmarrjen në diskutimet nga 16% në prill në 20%. Deputetët opozitar pjesëmarrjen më të lartë në diskutimet e patën në janar dhe shkurt kur arritën 29%.




Në seancat e monitoruara në maj gratë kishin pjesëmarrje e vet në fjalimet në 53%. Pjesëmarrje më të madhe te deputetet gratëka pasur vetëm në periudhën 19 qershor - 1 gusht. . Duhet marrë parasysh se deputetet janë 35% nga numri i tërësishëm i deputetëve në përbërjen aktuale të Kuvendit.



Nëse numri i tërësishëm i diskutimeve ndahet sipas seksit të deputetëve të cilët kanë marrë pjesë në seancat e monitoruara rezulton se çdo diskutim i deputetëve burra dhe gra ka zgatur mesatarisht nga 4 minuta.




Sipas pjesëmarrjes, nëse koha e tërësishme e diskutimeve pjesëtohet në numrin e tërësishëm të mandateve të pranura nga deputetët rezulton se në prill mesatarisht çdo deputet nga shumica (81 deputet) ka folur nga 4, ndërsa çdo deputet nga opozita (11 deputetë) ka folur nga 7 minuta. Nëse, ndërkaq, koha e tërësishme e diskutimeve ndahet vetëm në deputetët të cilët kanë marrë pjesë në seancat e monitoruara, rezulton se çdo fjalim i paraqitur nga deputetët opozitar ka zgjatur mesatarisht 3 minuta, ndërsa nga deputetët nga shumica mesatarisht nga 4 minuta.




I. LLOJI I FJALIMEVE DHE INTERAKSIONI

Monitorimi në maj tregoi rritje të përqindjes së replikave në nivel më të lartë në shtatë seancat e monitoruara të fundit. Përqindja e replikave u rrit në 20% gjë e cila është për 10% më tepër se sa në prill. Për llogari të kësaj u zvogëlua përqindja e diskutimeve për 11% krahasuar me prillin. Kundër-replikat mbeten pothuajse të përfaqësuara njëllor si në muajin paraprak.

Me këtë rast, si replika konsiderohen edhe përgjigjet të cilat i japin anëtarët e qeverisë në seancat plenare që ju kushtohen pyetjeve të deputetëve. Rritja e përqindjeve të replikave dhe të kundër-replikave mund të konsiderohet si indikator për interaksion me të fuqishëm midis pjesëmarrësve të seancave dhe këmbim më i madh i argumenteve në favor të temave të rendit të ditës.



Në seancat e monitoruara deputetët burra sërish e zvogëluan pjesëmarrjen në diskutimet në raport me muajt e kaluar dhe paraqitën 48% të fjalimeve individuale, 48% të replikave dhe 40% të kundër-replikave. Deputetët gra, ndërkaq, dhanë 52% të fjalimeve individuale, 52% të replikave dhe 60% të kundër-replikave.




II. SHKALLË E ARGUMENTIMIT TË FJALIMIT

Nga fjalimet e monitoruara të deputetëve, sipas Indeksit për cilësi të debatit, në maj numri i diskutimeve në të cilat diskutuesit pozitat dhe qëndrimet e veta i mbrojnë me dy dhe më tepër argumente shënon rrënie të butë krahasuar me muajin paraprak. Në maj të tilla janë 47% të diskutimeve krahasuar me 51% në prill. Në krahasim me muajt paraprak ajo është rritje për 4% në raport me marsin, 10% në raport me shkurtin dhe për 3% në raport me janarin. Prapëseprapë në maj përqindja e diskutimeve në të cilat janë të identifikuar dy dhe më tepër argumente është më i vogël se në muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2014.



Në maj me nga një argument janë mbështetur 41% të diskutimeve, gjë e cila është 5% më tepër krahasuar me prillin. Në 12% të rasteve argumentimi ka qenë i dobët gjë e cila është identike si në prill. Diskutimet në të cilat argumentimi është i vlerësuar si “i dobët” janë zvogëluar për 5% krahasuar me shkurtin dhe marsin Argumentimi është vlerësuar si i dobët në diskutimet në të cilat arsyetimi të cilin e ka dhënë diskutuesi nuk mjafton të konsiderohet si një argument i plotë.

Në muajt mars, shkurt dhe janar u vërejt trendi i zvogëlimit të argumentimit të diskutimeve me dy dhe më tepër argumente krahasuar me muajt paraprak. Në të njëjtën kohë u rrit përqindja e diskutimeve me një argument dhe të diskutimeve me arsyetim të dobët. Gjithashtu, në periudhën nga dhjetori gjatë këtyre muajve krahasuar me muajt paraprak që nga fillimi i monitorimit në qershor të vitit 2014, në minimum kanë rënë diskutimet në të cilat diskutuesit aspak nuk kanë arsyetim. Në seancat e monitoruara në maj nuk është shënuar diskutim në të cilin diskutuesi aspak nuk ka pasur arsyetim.



III. FUQIA E ARGUMENTIT MË TË MIRË

Në seancat e monitoruara në maj, njëloj si në periudhat paraprake, asnjë folës nuk është paraqitur me një pozicion që mandej të vë në pah se e ndryshon pozitën për shkak të argumenteve më të mira të prezantuara në diskutimin e diskutuesve të tjerë. Në monitorimin e deritanishëm, ndryshimi i pozitës për shkak të argumenteve më cilësore është vërejtur vetëm një herë në periudhën e parë të monitoruar (19 qershor – 1 gusht).


Në maj, në 16% të diskutimeve diskutuesit e kanë njohur vlefshmërinë e argumenteve të diskutuesve të tjerë gjë e cila është pothuajse identike si në muajin prill, por është në mënyrë drastike më pak krahasuar me muajin mars kur përqindja ishte 38%. Ajo vë në pah se një pjesë e diskutuesve në seancat kanë pasur pozita të njëjta me pjesëmarrësit e tjerë në debatet kështu që kanë shfaqur respektim ndaj argumenteve të tyre. Pjesa tjetër e diskutuesve kanë pasur pozita të ndryshme, por kanë shfaqur respekt dhe e kanë pranuar vlerën e argumenteve të kundërshtuara të shfaqura nga



bashkëbiseduesit . Mirëpo, njohja e vlerës së argumenteve të huaja në asnjë rast nuk ka sjellë në ndryshim pozicioneve të diskutuesve.

Në 21% diskutuesit nuk e kanë pranuar vlefshmërinë e argumenteve të shfaqura nga pjesëmarrësit e tjerë, e as e ndryshuar pozicionin e vet, dhe kjo paraqet rritje për 11% krahasuar me muajin paraprak. Kjo përqindje ka qenë më e lartë vetëm në janar - 23%.

Në 63% të diskutimeve diskutuesit aspak nuk u kanë bërë vështrim argumenteve të prezantuara nga pjesëmarrësit e tjerë në seancat. Ky është zvogëlim i kësaj përqindje krahasuar me prillin, por prapëseprapë kjo përqindje është më e lartë se sa në janar, shkurt dhe mars.




IV. RESPEKTIM NDAJ PJESËMARRËSVE

Në maj, krahasuar me prillin, deputetët diç më tepër shfaqën respekt ndaj deputetëve të tjerë, ndërsa pak më rrallë nuk patën kurrfarë raporti ndaj pjesëmarrësve të tjerë në seancat. Në Maj deputetët në 37% të diskutimeve kanë shfaqur respekt ndaj pjesëmarrësve të tjerë, ndërsa në 45% nuk kanë shfaqur kurrfarë raporti ndaj deputetëve të. Në prill diskutuesit në 30% të diskutimeve kanë shfaqur respekt ndaj pjesëmarrësve të tjerë, ndërsa në 63% % kanë mbetur neutral, përkatësisht nuk kanë shfaqur kurrfarë raporti ndaj deputetëve të tjerë.

Shkalla e respektimit të pjesshëm është rritur për 10% krahasuar me prillin dhe është 12%. Respektimi i pjesshëm do të thotë se folësit në masë më të madhe të diskutimeve të veta kanë qenë neutral ose kanë shfaqur respektim ndaj pjesëmarrësve të tjerë, por në pjesë të vogël kanë drejtuar edhe sulme dhe fyerje personale ose partiake. Ndryshim vërehet edhe te përqindja e diskutimeve në të cilat është vërejtur mos-respektim i pjesshëm. Në maj kjo përqindje është 5% krahasuar me muajt e kaluar kur pothuajse edhe nuk ka pasur diskutimev të tilla. Mos-respektimi i pjesshëm do të thotë se folësi në pjesën më të madhe të fjalimit të vet drejton sulme dhe fyerje personale dhe partiake, por në pjesë



më të vogël kanë pasur raport neutral ose respektim ndaj pjesëmarrësve të tjerë. Në 1% nga rastet diskutuesit kanë shfaqur respekt eksplicit. Respektimin eksplicit para së gjithash do të thotë se deputetët në diskutimet e veta kanë drejtuar lëvdata personale ose partiake ndaj pjesëmarrësve të tjerë në seancat. Në maj në seancat e monitoruara nuk janë vërejtur diskutime në të cilat deputetët tërësisht ose në pjesën më të madhe të diskutimeve shfaqin mos-respektim të plotë ndaj pjesëmarrësve të tjerë.



V. RESPEKTIM NDAJ ARGUMENTEVE


Në maj deputetët më shpesh ishin neutral, përkatësisht nuk prononcoheshin ndaj argumenteve të folësve të tjerë. Kjo është vërejtur në 58% nga diskutimet gjë e cila është zvogëlim serioz në krahasim me prillin kur të tilla ishin 80% nga diskutimet.

Në maj përqindja e diskutimeve në të cilat është shfaqur respekt ndaj argumenteve të diskutuesve të tjerë është rritur për 10% krahasuar me prillin dhe arriti 29%. Shfaqja e respektimit ndaj argumenteve arriti nivel më të lartë që nga fillimi i monitorimit, në periudhën e parë të monitoruar 19 qershor – 1 gusht, kur kjo është vërejtur në 74% të diskutimeve. Në dhjetor, nga ana tjetër deputetët shfaqën më pak respektim përkatësisht vetëm në 8% të rasteve.

Në maj në 11% të diskutimeve folësit shfaqën respektim të pjesshëm të argumenteve të diskutuesve të tjerë. Kjo do të thotë se në pjesën më të madhe të diskutimeve janë neutral ose shfaqin respektim, por në pjesë më të vogël shfaqin mos-respektim ndaj argumenteve të folësve të tjerë. Është rritur edhe përqindja e diskutimeve në të cilat është shfaqur mos-respektim i pjesshëm ndaj argumenteve të diskutuesve të tjerë. Me këtë rast nuk janë vërejtur raste të mos-respektimit të plotë të




argumenteve të prezantuara nga deputetët e tjerë, e as raste në të cilat është shfaqur respektim eksplisit.



VI. VËLLIMI I ARSYETIMEVE DHE I NDËRPRERJEVE

Në maj në 29% të diskutimeve, pjesëmarrësit ishin neutral, përkatësisht nuk i ndërlidhën argumentet e veta me me përfitime ose pasoja për grupe të tjera, përkatësisht para së gjithash me grupe të tjera sociale në shoqërinë, ndërsa më rrallë me grupet e veta etnike ose politike. Kjo përqindje [shtë më e ulët krahasuar me prillin, marsin, shkurtin dhe janarin.

Për llogari të zvogëlimit të përqindjes së diskutimeve në të cilat deputetët ishin neutral, në maj është rritur përqindja (49%) të diskutimeve në të cilat deputetët i ndërlidhën argumentet e veta me përfitime ose pasoja për të mirën e të gjithë qytetarëve përkatësisht me të mirën e përgjithshme. Në 13% të diskutimeve, diskutuesit i ndërlidhnin argumentet e veta me përfitime ose pasoja për grupe të tjera, përkatësisht para së gjithash me grupe të tjera sociale në shoqërinë, ndërsa më rrallë me grupet e veta etnike ose politike. Diskutimet në të cilat deputetët i ndërlidhën argumentet e veta me përfitimet ose pasojat për grupin e vet u rritën për 6% dhe arritën 8%.



VII. GJUHA E PAHIJSHME

Në pikëpamje të gjuhës së pahijshme, pjesëmarrësit në debatet e monitoruara kuvendore në këtë periudhë në përgjithësi përmbaheshin nga përdorimi i saj. Në maj nuk janë vërejtur raste kur deputetët kanë përdorur gjuhë të pahijshme ndaj personaliteteve të tjera në seancat. Gjithashtu, nuk është vërejtur rast i kufizimit të deputetëve ndaj diskutimeve të tyre nga ana e diskutuesve të tjerë.

D. KONKLUZIONE:

- Gjithsej 20% të diskutimeve në seancat e monitoruara në maj u takojnë deputetëve opozitar që paraqet rritje të sërishme të pjesëmarrjes së opozitës në diskutimet kuvendore. Kjo është më tepër se sa në prill dhe mars kur kjo përqindje ishte vetëm 16%. Kjo rritje ka të bëjë në atë që në maj opozita është e përfaqësuar nga një deputet më tepër për dallim nga muajt paraprak. Në maj opozita në Kuvend numëron 11 deputetë pasi që partia DOM e braktisi koalicionin qeverisës.
- Sipas seksit të diskutuesve, gratë ishin më të përfaqësuara me 53%, ndërsa në llogari të kësaj murrat ishin të përfaqësuar me 47% nga të gjitha diskutimet.
- Pyetjet e deputetëve, Propozimi për zgjedhje të anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, propozim ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për mbrojtje të konsumatorëve dhe raporti vjetor të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë shkaktuan diskutim pak më të madh midis pjesëmarrësve në seancat. Një pjesë e madhe të pikave të tjera të rendit të ditës kaloi me diskutim të pakët dhe të njëanshëm ose pa kurrfarë diskutimi.
- Deputetët në maj më shpesh i mbështesnin qëndrimet e veta me nga dy dhe më tepër argumente krahasuar me muajin paraprak. Dy dhe më tepër argumente janë identifikuar në 47% nga të gjitha diskutimet në seancat e monitoruara. Në të njëjtën kohë u rrit përqindja e



diskutimeve në të cilat deputetët i përkrahnin qëndrimet e veta me nga një argument për 5%. Me këtë rast numri i diskutimeve në të cilat deputetët kanë pasur arsyetim të dobët mbetet i njëjtë (12%) si në muajin prill.

- Është zvogëluar përqindja e diskutimeve në të cilat aspak nuk i vështrojnë diskutimet e tjera për 14%, ndërsa u rrit përqindja e diskutimeve në të cilat deputetët nuk e ndryshojnë qëndrimin e vet, por e pranojnë blerjen e argumenteve të shfaqura nga deputetë të tjerë për 10%. Përqindja e diskutimeve në të cilat diskutuesit aspak nuk i vështronin argumentet e prezantuara nga diskutuesit e tjerë në maj ka qenë 63%.
- Pjesëmarrësit në seancat sërish nuk shfaqën interesim dhe gatishmëri për ndryshimin e qëndrimeve për shkak të argumenteve më cilësore të shfaqura në diskutimin. Në maj janë shënuar vetëm dy raste në të cilat deputetët e kanë ndryshuar pozicionin e vet, por nuk janë sqaruar për cilat shkaqe e bëjnë atë.
- Në maj diskutuesit më rrallë ishin neutral krahasuar me prillin. Kjo do të thotë se nuk i ndërlidhnin argumentet e veta me përfitime dhe pasoja për asnjë grup etnik, social ose politik ose për të mirën e përgjithshme për madje 37%. Për llogari të kësaj u rritën përqindjet e diskutimeve në të cilat diskutuesit i kanë ndërlidhur argumentet e veta me përfitime për të mirën e përgjithshme (49%), grupet e veta (8%) dhe grupe të tjera (13%).
- U rrit përqindja e diskutimeve në të cilat deputetët kanë shfaqur respektim ndaj deputetët e tjerë për 7% krahasuar me muajin prill. Në të njëjtën kohë për 10% u rritën edhe diskutimet në të cilat deputetët shfaqnin respektim ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të tjerë në seancat.
- Deputetët përmbaheshin nga përdorimi i gjuhës së pahijshme, ndërsa në këtë periudhë asnjë herë nuk është shfaqur as mos-respektim i tërësishëm ndaj pjesëmarrësve të tjerë në diskutimet as ndaj argumenteve të tyre.
- Diskutimi rreth pjesës më të madhe të propozimeve ligjore mbetet në përgjithësi i dobët dhe nuk mundëson që përmes debatit publik të testohet vlefshmëria dhe qëndrueshmëria e argumenteve të përgatitura dhe të prezantuara të deputetëve. Me atë lëshohet mundësia që argumentet të kontestohen ose plotësohen, dhe me atë opinioni është i varfëruar për pikëpamje të ndryshme të cilat do të kontribuonin për përpilimin e vendimeve më cilësore në favor të të mirës së përgjithshme dhe të interesit publik.

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit publik dhe diskursit deliberativ” është i financuar nga Unioni Evropian.



Ky publikim është i përgatitur me ndihmë të Unionit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe në kurrfarë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shfaq pikëpamjet e Unionit Evropian.